



NANDO ELMO

VJERSHET E  
HELMIT



PITTI  
EDIZIONI

**Nando Elmo**

**VJERSHET E HELMIT**

*Redaksi e re me ndreqjen e gabimevet e të parit botim në kartë*



*Kopertinë e Cesare ELMO*

**Nando Elmo**

**VJERSHET E HELMIT**

*for those who drink of bitterness  
(Ezra Pound: Pisan Cantos)*

## ***Kushtim***

*Kujit këta vjershe  
Të kotë  
Çë dëshpërisht  
Kërkojinë  
Merë  
Buzëqeshje e njëj momenti  
Të livanisjin qiellin tim vakand  
I kushtonj?*

*Tek ki dhespër  
Përpara derës regjërore së madhe  
Ngrënj thimjatirin  
E këndonj falin e ikjes*

*Kujt do t'ja kushtonj  
Këta vjershe  
Çë me zëmërim  
Kërkojin sa të mbjojin honin  
E thartimit?*

*Zefit  
Margeritës  
Çë me fjalë të përshtatshme  
Mbjuan vakandin e jetës*

*Miq ndlemni  
Ndose dhurëtila  
Ngë hipet te lartësia juaj  
Leni keto tharti  
T'i ëmbilsonj  
Mjalthi i miqësisë*

## I

*Zefit Skiro di Maxho*

Ndërsa djovasnja disà vjershe të Montale-t  
- Sa largu jam ka hollësia e tij -  
M'erdh kujtimi  
I buzqeshjes tënde

Ironike

Qetin nga urtësi

Mosnjeriu i jep  
Siqiljan si je  
Të sprasmen fjalë

Ujë çë lan  
Gjithë kotësitë tona

Livrisa baltën  
Më ranë fjalët njera pas tjetrës  
Nanì terem përposh diellit të Horës

## II

Ket mbrëmanet e të korravet  
Ket dreka e verës  
Ndë mes të gazevet të gravet  
Kur zëjin korrëtarët  
Zëmërin më lëmë

Ket hera kur këndonej e vetme një cînixir  
E bij hjea ndër vreshtat  
Ket piqshin rrushtë  
Par se të zënej nj'arganetar t'i binej  
Vej dhon Oraxi  
Ture i shkruajtur më zëmër poezit'e tija

I pirsëritnej katundi

Kishin kujtim ahirna e kishin shpirt

Do të prirsha ket ajò gjitonì e qosme fjalësh  
Çë thojn përpara zjarrit  
Vërteta t'ulta e nga tringël ish zër'i njëj Hyjnie  
Do të prirsha sa të mbjaksha si të mbdhenjëtanë me urtësi  
Pa çotitë e sosme

I paqme e pa rrunganxje ndë mes të shurbisevet çë rreth na  
rrijinë

E çë mbjakshin ahirna bashk me ne

Na bëri pa krye shkencja e rrimi si kronje çë ngë nxierjin etë

### III

U shtruan ket kaltria  
Retë si dhen çë kullotjin livadhet pakufinj e qiellit  
Bie kumbor'e madhe  
E masin qetësinë e shpivët të lëryera  
T'asaj ç'ish një herë Firmoza

Fryn ka shtegjet e bregut



Një livandinë e hollë  
Do të siell shi  
Mbë mosnjeri ç'e pret

U egërsuan ullinjët  
Hjersa vreshtat  
Një mollë kurçe një qirjerinë cimbin

U shkatarrua  
Mjalët e arëzës që fjeturon  
Ket këtò mbersa të shkreta ç'ishin kopshtira

Babaret zëmëra  
Shpirti së ka më kufinjt' e tij

Si ven këtò fjalë  
Çë ngë zën valle?  
Duken shërtime  
Duken rahalle  
E rrinë si ujë më zjarr që nëng zë val

#### IV

Buk'e mbëlhasur poezia ime  
Çë përsëritin urtësi të moçme  
Thonë se sesi shkruanj

Sesi pindaksinj u nëng bëhet më  
Na mundi rritj'e historisë  
Hegeli bën akoma skollë

E kan t'urtë që kështu e ndiajin

Po jam ateist  
Ngë kam sipër kryet mos ndonjë idol  
Thon se ke të vesh për prënjet  
Për honet e vetëhesë tënde  
Për stalat sa të riminarsh koprè  
Ke akoma t'i trëmbish borgezrat  
Sikurse kjò ng'është urtësi borgeze

Shanj *Croon-eret* çë Taorminë  
Gjithë ditin i lemojin veshët  
Amerikanëvet

Po jam shkrimtar i ndrishëm i shkathët  
E sesi mundin kundrastonj ditin e sosme  
I lë ujravet, si Koheleti, bukën time e djersur

## V

Na perendimorë  
Të ngar ka ankth'i trakulimit  
Së do të kemi më  
Thavmasjen e njëj agimi

## VI

Këtë ç'u ju thom mund t'jetë se ë çotì  
Po mirrnie vesh  
Vëni kufi

Ngë lë ëndrrën e atëdheut tim Greqia

Pse këtë më shtu Perëndia  
Ket flitej greqisht  
Çë kur vu rrënjë  
Μεγάλη Ἑλλάς  
E rregji Itali piksi Sisicet

Gjithve një qelq verë  
Një thelë bukje gjithve  
E ndrequr me udhos

Ng'e ndrronj ëndrrën e atdeut tim  
Se dua të klanj Morenë  
Më se mortjen e Skanderbeut  
Çë më duket shurbès litì

Bëra këtë folë çë ngë dija të kisha  
Mbrënda ket këmisha e zëmëris sime  
Ish klisha pa kumborë  
Ket këndonja *Φῶς ἰλαρόν*  
Ose *ὅσοι εἰς Χριστὸν ἐβαπτίσθητε*

O ndër dhesperet  
*θεὸς κύριος καὶ ἐπέφανεν ἡμῶν*  
Ngë njofa më të math kungim

Ngrëjta këtë klishë te dheu i huaj  
Sa të lemoja angthet e papërkasjes sime  
Po njota ngrëhen shërtime  
Sot më duket gjithësej çotì

Po kimni paçenxë ju zotra  
ju lëpinj lipisì

## VII

Kur djalosh u nisa ka lartsitë e Firmozës  
Shinja llargu një mur ku mbaronej jeta  
Ktjè – më thonej një zërë - mbaron udhëtimi it  
E prapa murit dhera kodhra vreshta kopshtira  
E detin Jon që mbllin orizontin  
Ku zë pakufiri

Nani që ju qasa murit  
Ai më pengon sa të shoh mbatanë  
Nëng mendonj më hapësirat  
Çë një herë vrenja

Ndose thërres  
Mos ndonjë jehon më përgjegjet  
Vet muri sipër më rri

## VIII

*Për K.*

Kur të lëmonj  
Cilën fytyrë tënde  
Jam e lëmonj?

Cilën zë tënd gjegjinj  
Ndose nëng lodhet veshi  
Prapa zëre të rinj

E ndose i vë re syut tënd që gjelbëron  
Si gjelbërojin dherat tanë në paraverë  
Vocele

Ket cili liqen jam e pasqirohem  
Narcis i moçëm?

Ditë pas ditje më paraqitin moti syvona të rea  
Anagasen vërtetat tona  
I shtrohen të sigurta përpara shpirtit  
Po jotja më gjimton

Nj'errësirë e madhe  
Të fashion

Buttom ti udhën  
Për të t'e arrënj

Çëlëm dritën  
Çë mund të dritësonj  
Te fundi mbambarrarem  
Nga herë adunarëm  
Se kur të kërkonj  
Kërkonj vetëhenë time e malingosur

Së cilës  
Na çë vet atë duami  
Dimi vet se ngë dimi ç'është

## IX

*Mi corazón latía atónito y desperso*  
(Machado, Soledades)

Përsëritinj ëmëret tuaj  
Miq ç'u bët kujtime

E më skretëruat botën

Nëng nëmëronj motën ka i cili u qetësuan gjitonitë

Ndose na të qlluar hapmi sytë

Vet te momenti ket i cili shpirti na lyren

Nani ç'ju mejtonj

Ikni

Livand çë hipet

Sa të bired

Ket qetësia e qiellit

Xhuà, Nikò, Pinù, Vervè

E shkëlqiera Memè

I pjoti nder Alfrè

I urti Ndò

Qesharaqi Binù

I shëjti papas Viçè

Dhon Leò

Dhon Spì

Kopositë lodhësitë trëmbësitë

Dashuritë martesiet lipet

Skisat

Urtësitë e Firmozës

Mëmë e at

Sa qet hje

Sa jini

Të thieshtë ëmëra

Lëmonj varret

Shtie shkikuj verje më truall

Si bëjin për spirtën tuaj

Të mëdhenjtë tanë

Ju kustonj lule mali pa merë  
Ket kjo stinë e agur

Kem' të pirsëritmi sa ëndër është gjella?  
Na u lodh gjufa me urtësi të pavlerë  
Edhe fjalët na lëshuan

Ket zëmëra ime e errët e mungare  
Zjarm i kotshëm  
Si thot një poet  
Mos ndonjë kryqe gjymton

## X

*... ses racines de souffrance  
à mon côté dès l'âge de raison ...  
(Rimbaud: Une Saison en enfer)*

Ullir i rropartur  
Pa lëng  
Fantazm i bër

Ka toku i motit  
I ngatarriet  
Te fati i lig të familës sime

Të sfartur  
Petkun tim e pe  
Pe shpin e shitur

Te pasiqiri i trubulluar të harramjes  
Hje shkojin  
Dherat që mbjojin sënduqe me grur  
Thekër e trikomel  
Xhara me valë  
Bute me ver

Kishin furret bukat e tyre  
Burxunielet të lyert

E merojin fiqësh  
Molash çistat ndër tavuletrat

Ëmnonj kotisht  
Farnitat e vreshtavet  
Massavetrat e ullinjëvet  
Gallatrat e kështënjavet  
E të korravet Pandanat  
Brinjin e madhe e festës

Lëme të djalerisë  
Vallësore

Lefjin qenët  
Te perëndimi ture mbjedur  
Kaciqe e shtjerra  
Te skaraci

Kishin kasuralet djathe  
E që sumarshin gjiza

Shkojin te gjitonit bularë  
shkojin zonja



Kishin kopile qesharaqe

Çë tandon gjumin tim?  
Cilët ëndre paraqitin  
Merëngia e ikjes?

Po lavdì Zotit  
Për shqitjen ka gjisej  
E vñv ἀπολύεις

Nani çë më dhezet  
Te buzqeshja e dhesperit  
Një dritë gazmore  
Çë më mashtron

Qaset moti  
E moti ë dhja ki  
Çë më thot  
Se çë do shkova kle faregjë  
Edhe sa shkuan pësimet e djalerisë sime

## XI

*... në sachant m'expliquer sans  
paroles piennes...  
(Rimbaud: une Saison en enfer*

Vete si poeti grek Solomoni  
Ture marr hua fjalë  
Nani ç'ë e mbaron një botë  
Çë imja ngë qe kurrë

Mi vlezër u spavtin

Me kë kam të fjas?

Cilat lavdi mund të ngrënj ka zëmëra  
Për të cilin Zot?

Atij çë e më lyren nani

Nani çë pe lirin' e tij  
Ç'është padomethënija e botës

Vonë vonë shum vonë

Lavdi tij Zot për dukjet mashtrore  
Me të cilat na lëmove  
Te pësimet e gjelles

Njota se është e shkon e sprasmja hje gazmore  
Gëzohet te një moment  
Shpirti

Një sponxë  
Me uthul kryqësuarit  
Sa mos të ndienj  
(Fat'i ëmëravet )  
Helmet

## XII

Pa kreni  
Ultësisht  
Vura karriqen prez kopresjes së Jobit  
Me ndër veshë zërën e Koheletit

Kotësi kotësish  
Gjithë është kotësi  
Edhe vepra Jote

### RREPTËSI

Thërret Jobi te durim'i tij  
E kotësisht priret  
Jo e njëjta  
Jeta  
Kotësisht mbrasen lumet ndë det  
E kotsisht stinat priren

Po fare gjë priret

Gjithë vete ket vat ju miq prindë vlezër motra  
Ka ku ngë do të prireni kurrë

Një dëtyrë  
Jin'e paguani  
Vet pse qet të thërritur ka faregjëja  
Vet për një buzqeshje e rremë  
E pjëhra u pruartit ket pluhuri  
Çë nj'er'e ligë e perëndimit shprishin

Fare gjë priret e çëdo lehet  
Shpërblen ftesën e të mbdhenjëvet tanë

Të hapurin e syvet

Mblimi sytë pse  
Gabim'i Hyinivet nëng do par

### XIII

*Μηδὲν ἄγαν*

Një i lën  
Te lënsia e tij tha se  
Gjithësej do të priret  
Jo për *esprit de ressentiment*  
I prier, tue e falënderuar, profecin' e keqe

Nëng kam shpirt trimi  
E dua të shuanj nga vëlimë pushtetje

### XIV

Shërbenj sa të harronj se shërbenj  
Lodhem sa të harronj se lodhem  
Gjellonj sa të harronj se gjellonj

Vet dhëmbjen nëng harromi t' e harromi

Po ti vocele gazmore  
Rrim përpara me të mirat e dhurtolet tote  
Sa të harronj se harronj

## XV

*Le fue dado el lenguaje esa mentira  
(Borges: Los dones)*

*.... Es bleit uns vielleicht  
Irgend ein Baum an dem Abhang ...  
(Rilke: Duineser Elegien,I)*

Fjalë  
Ti çë piksin bota  
Nani ç'erdh dhesperi  
Lyre shebëtorin tënd

Të kerkova  
Ndër angonet më të ngushtë  
E m'ike nga herë ka duart

Gjetkë fjuturove  
Ture thën ndrishe ka mendimet e mi

Ndrove vërtetat  
Në të rreme  
Të rremevet  
I dhe forcë  
Njera sa gjak të shprishjin

Na qelle llargu ka deshe

Po u firase edhe ti

Përposh dielit të së vërtetës  
Ture thën se e ndryshme ë fjala  
Ka bota çë do të shprehënj

U kalbe  
Si një pemë çë muar shum shi

Rri ka Shinjanjezët një shtog me majapkat e tija  
Sesi mund të shpresonj vetmin' e tij?  
Cila fjalë i jep ëmër?  
E ujravet e Grondit  
E të gorricës ka Llumunjelthi  
Ka hin më verë një ftohtësi e hollë?

E kaltrinë e syvet të pleqvet  
të njomthë  
Të lagët për lotë të rrëjitur  
Si do t'ë thomi  
Cila fjalë i mban shefur domethënëjen  
Ndose na dim'ë shprehemi vet me fjala të huaja?  
Vrejin ka dhoqet e sheshevet  
Perëndimet e mallengimit çë ngë ka të rrëfier

Atë çë kish të thufej u tha

E s'kan fjalë të rea

Nani sherbëtorin tënd Ti lyre  
Mos tando më  
Lodhësin' e tij

Do të mbanj kujdhesin të prier

Ket vetmia ime e vakand  
Si një titarot  
Çë ngë kendon më lotët e dashurisë

Mbanj  
Tash ngryq më sjet krafet  
Si një ç'i varth s'ka më çë të bënj

## XVI

*En el arango esta la estrella  
(Jiménez: La estación total)*

Te dhesperi i gjat  
Ish theristiu  
Ndër muajet më i ziu  
Këndojuj fjala të moçme  
*καὶ ἐπέφανε νῆμῖν*  
T'esurvet  
Ndersa lavdia e Perëndisë  
Kish përbënën e njëj dhunëje

T'esurit  
Ngë na lëmonej mos ndo një këndim  
E fjala spavej  
Te zotria vakand  
E qiellit  
Të ngjier portokallje  
Çë ngë njofmi e nëng na njeh

## XVII

E butë më vren me sytë tat  
Si të butë timët  
Pse ngë kam thonjë  
Sa të gërmonj zorrat tote  
Te thellsia e kësaj humbje  
Ket qelbësitë  
Gjellon e vërtetja

Ndose buzqeshja jote  
Ësht një gënjim

## XVIII

*No, mi corazón no duerme  
(Machado, Soledades)*

M'u mbjodhtin rreth  
Kushëllinjët e Jobit  
Miq pjot hollësi e mirndiemje  
Filozofi teologji  
Shkencë

Do të më zgjojin ka mor'e fatit të keq  
Po jam një të cilit ng'i zë gjumë

Kujit kam t'i bindem?

Shaturi pa rrëkime  
Nëng skrifin koposin'e tij

Dua të rri këtu



Ket angona e vatrës  
Sa të kem hi të shtie më krye

E të ngjurrinj zërin  
E parkalesjes sime pjotë mallkime

### XIX

*in den gekosteten Vorschlaf...*  
*(Rilke: Duineser Elegien, III)*

E mbrehte gjëmbë  
E dëshirit

Të ndryshëm qëronj  
Kur nata e sqetësuar  
Ngë kish ylle  
Të më bëjin dritë

Losnja ëmbëlsinë  
E figurës tënde  
Prapa vetula pjotë gjumë

Më vijin suvalat e kaosit  
J'arrënej i fshefuri ftesor  
Zot'i gjakut  
E lëshonja lënget  
E vetëmisë sime

Mb'udhën e natës vete ajri  
“Ku vate moti  
Çë ish më njëhere...

”

## XX

Ngë façohe më  
Ka finestra të më thuash  
Çao

Varri ë e të ha  
Kurmin  
Gjakun çë levrisej  
Jo vet veshlat time

M'u burthua një natë Vallesh  
Mua mik i garrafunevet  
Midhis linjavet tënde  
Gjizë dhije

Ligja ish  
Past kurmi atë çë i përket atij  
Pse shpirti pa llikuzhit e tija  
Nëng vë penda

E fjuturova  
I dashuri mëkat

Ngë façohe më ka finestra  
Të më thuash  
Çao

Të më tandosh  
Natat e pritjes  
Çë ngë pirsëritjin

Të parën mallmadhi

Pashe si thuhet paqë  
Ndersa neve gjella na marrunarin  
Me deshire çë skomollisur ngë duan

## XXI

U lodhëtin fjalët

Një filosof thot se jemi bilët e tyrve  
Më se prindvet tanë

Lefemi te një botë tash e intepretuar  
E fashquar si te kukula sirku

Disa na magjepsjin  
Ture na rrethuar si fjutura të pikëluara si brez'i plakavet

Disa si grere  
Na farmakosjin

Të tjera kotësisht  
Spaven si fumat cikarri  
E priremi t'i shtridhmi si llimune pa lëng

E tonat

I përsëritinjt si brumbulli me kurrizin e artë kopren  
Për të ngatarrenjt  
Një kukuban

Çë nëng qëndron kurrë  
Jetën tonë arbëreshe  
E cila ka ngyret e djalerisë e parrëmbieshme

## XXII

*En une façon de patois attendri  
(Rimbaud: Une Saison a l'enfer)  
... notum si callida verbum/  
Redderit iunctura novum  
(Horatius Flaccus: Epistulae)*

Kur jam jimaz ka im bir  
Rekuperarinj i pir si jam  
Kundër shantazhin e shëndetjes  
Piaxhirin e sigaretës

### Sigaret mejtimi

Fumata vete pir lli fatti të saj  
E u s'i kam kontrol procesit të djegjes  
Çë pa rraxhë vete te kufir'i saj  
Dreq sa duhet  
Vete tebaneria jonë  
Jemi tash te mucikuni

Pesqind vjeç  
Kan më pak hapësir se nj'ëndër

I masa fjalët  
Ze'

Kërkova ture veshur arbërisht  
Fjalë litire  
Atë bashkim të urt  
Çë thon se bën të rea  
shprehjet të vjetra

Te magja ime gjuhsore  
Brumit nëng fryfet po

### XXIII

*Ndonit të Sasonvet  
historian ka Ungra çë nani banon mbatana*

Vrenj mik  
Çë pate fatin e keq  
T'ikje par motit  
(I kish zili urtësisë tënde  
Ndonjë hyjni shkatinj)

Librin tënd të rënd  
Mbë historin e Villa Falconieri

I bëre këmbëzin dijturisë së skollevet

Ç'është historia? pyen  
Disa t'urtë, ti thua, e thon  
Përqeshje t'atyrve çë rrojin  
Të vdekurvet  
Disa tallje të vdekurvet  
Atyrve çë kan akoma bindjen të gjellonjin  
Edhe me sytë e haptë

Ti më i zgjuari  
E thua lozje  
Ç'ata çë rrojin i bëjin shokvet të tyre

Kujtimi nëng na sosin  
Vemi si te nj'ëndër  
Nga herë çë rrëfiemi

## XXIV

*Kai tous κτανόντας άντικαθνεϊν δίκηι  
(Aeschilus:Koephorai)*

Një i shkurtur blegërim  
Te thertoria i ngjatënej  
Me këmbët e lidhurë  
Kaciqe e shtjerra  
Trallishi<sup>1</sup>

Pinej gjakun e tyre gjitonia

Të rrjepu  
E të varur te gërrjepçi jashta derës së qëngës  
Na vrejin po të butë me sy pa vetulla  
Me gjuhin anamesa dhëmbëvet  
E cila të lipnej gjakmarrje nëng kish pasur mot  
Ushqim ushqimi  
Si nga gjë  
Këtë dojin Pashkët  
E Natallet

---

<sup>1</sup> Supranom i qangierit të gjitonisë sime.

Po thertorien e saj  
Këtë e doj gjella  
na paraqiti Dike

Dëtirin tonë  
Te mot'i caktuar  
Do t'e paguami  
Ka krimbat do t'jemi ngrën

## XXV

Qellshin si motërma  
Zonja Ruzar'e Xhilotit e Zonja Mari'e Kaluqit

Me një “zotrote” i drejtohej njera tjetrës

Hollësi e zotërisë së tyre

Le Zot të bisedojn kështu  
Te dhoma e pritjes së qiellit  
Tue mbar njera duart  
Te prëhri tjetrës

E ture shkëmbier fjalë fletake  
Pa merë si i dy qirjerinave piptimi

Si ngë bën këtu  
Te bota e kujdhesit të rënd  
Te ku i shture

## XXVI

Më dhëmbet  
Se shpitë e bujarvet të Firmozës  
Janë vakand  
Kujtimi pak më ndifin  
Sa të ngjallin hjetën e tyre  
Te prahu i dritësorvet  
Te dhoqet te ku asedhe u prëhem

Më dhëmbet se janë të banuara  
Ka të huaj  
Ç'i ngë më dhanë mosndonjëherë  
Një falënderim

Çë ngë rrëfiejtin pralla  
Te dhesperet e verës  
Kur zdrypej ka Shimremali një ftohtësi e hollë

Këtje tringëllisnej martjeli i Nofarit  
Këtu i bij kitarrës mjest Kaparelli  
Mallkonej gjithë shënjtrat lal Nxellmi  
Kur hunjë dhollarnej për udhritë  
Gruaj'e Tinjës qesharaqe thojë skandalet e saj  
E ce Rrusaria e ullur te dhoqea pinej të sprasmin kloqë

E mbushur vetmie  
Ngjatet hjea ime  
Te dera e cje Maries së Ponit  
E cila më kish streksur ture djovasur flakat e zjarrit  
Një ardhje pjot hajdi  
Σῶσον κύριε τὸν λαόν σου  
Zot kotisht të parkalestim të shptonje popullin tënd



## XXVII

Ishe dëshiri i gjithë Firmozës

Erdha edhe u i trëmbëshëm  
Te një natë pjot angthe  
Sa të trokollisnja te dera jote

E deshe djalerinë time  
Çë ngë kish vën akoma mjekër

Nani të trokollisi moti  
E të skretëroj shtratin

Fikson sytë te vakandi  
E një i huaj të qellin ket ti ngë do

Kish ligjë dhon Fernandi  
Çë më djovasnej të mbdenjët tanë  
Ata çë thanë gjithesej par se t'j'arrëjnim na  
I madhësonja të mirat e tua  
E te kaltria e syvet e tij  
τοῖς' ἴκελοι πήχουιον ἐπὶ χρόνον ἀνθεσιν ἤβης  
τερπόμεθα  
Neve çë jemi, thoj, si fjeta ç'u len te paravera  
Njize na zë dridhëma e dimrit çë na firasin

Dëshir'i Firmozës u shua  
I pjekosur ka moti  
E vete pa merë  
Biret ket nata ai këndim'i djalerisë  
Στρώσε το στρώμα σου για δυο

## XXVIII

Sa qelqe masa me Pallinotin e Mik Sesorit  
I cili nani banon me hyjnitë e botës  
Me të cilët nëng pifet kurrë

Të sprasmin me raki Triest  
E frynej një vore e rreptë

Na ngriti dorën  
Ndersa e ngrejim  
Për një përshëndtje e rreme  
Se gjella prana Pallinotit nëng ju ngjat.

## XXIX

Hapshin trapitet

Kallarshin ka Pallaci mjergulla të trasha  
Ndersa na zëj val gjaku

Hajim çaudele të pjekura  
Të ndrequra me valin e ri

Më vaft shtrëmbur  
Ndose ngë të mendonj  
oj Fedheri mjeshtr'i zjarrit

### XXX

Hëngtim të harepsur sa na mundi pjënsi  
E pim verë të çmendshme

Difet se për nom natyrje  
nga hirë ka të kundërtin e tij

U dejtëm sa mos nakatosjet t'i adhunarshim  
Prapa muzika qiellore i vamë

Për Çajkoskin e Bollen  
Shqitez çë ngë ka të njëqënshtëm  
E harruam  
Varfërinë njerzore

Vanë lotët e Xhuanit Balma  
I cili edhe pa verë  
Qan vet për hajditë e muzikës  
Sa të harronj se frymorvet edhe nga ngulje  
i siell koposi

### XXXI

Tha një i urt  
Se jetri është pisa jonë

Mbanj mend atë zjarm i egër  
Çë ngamon tij m'afërsonej  
M'u dhëmbe ket gjaku

Kërkova mos t'isha pisa jote

Ndomos se fati na bëri  
Nevoj'ë të tjetrit

Njetër pjot urtësi më kish bën të bindur

Ndose mir e do  
Llargu i mbetshe

Midhis trakulimit të pe e të haraksurit  
Tij çë të kërkova e nëng të gjeta  
Se anangasëshe me një të huaj

Me një garbëlizë ndë krah

### **XXXII**

Hiri  
Halez  
Harrove helmatar harakset  
Holqe hapësirat himas  
Hjetë hjidije

### **XXXIII**

Ti zot' i dëshirvet  
Lem

Pse akoma më babarin?

Vete i penguar  
Pa fjalët e përshtatme

Te vjershet tim  
Të vetmë të ngarkuar  
Sa të thon vërtetje  
Të cilavet sesi do t'jenë  
Ng'i kam benë

Ftesin vet  
Një koposi brumbulli  
vëllejtarsia ime?  
O jam i marr ka lozja e pakujdhesit  
Me të cilin më shpëton ka lënsia e gjelles?

#### XXXIV

*Dalje*

Tij këto fjalë të vapke  
Çë më dhurove me gjakun  
Ti siell si lulet e malit  
Të tillat thonje se më se ato të kopshtit ti i donje

Lulet  
Skutinat si i thon' e Shën Mërisë  
Me trandafilat e egra  
E skallieret e Brinjës së Madhe  
Ti siell tufë e lidur me një nok malli

Gjëmbat na ngasjin neve  
Nëng na i kursej gjella  
Nga shenj dashurie edhe te kujtimi na e bëri breme

## FJALORTH

breme = *rimorsi*

burxunielet = vurzunjelet= *contenitori di terracotta per conservare cibarie olive, grasso di maiale ecc...*

çaudele = *bruschetta, ciambella*

cìnxir = *cicala*

çistat = *ceste*

dhja = *appena, solamente*

dhollarnej = *piallare, levigare, fare la punta*

esurvet = *affamato, assetato, bramoso*

Farnitat = *Farneto, toponomastico*

firase = *disidratato, deperito, diseccato*

fshefur= *nascosto*

Gallatrat = “*Galatro*”, toponomastico

garbëlizë = *panno bianco di lana grezza, scialle*

garrafunëvet = *damigiane*

gërrjepçi = *uncino*

greere = *vespa*

jimaz = “*in campagna*”

kasuralet = *Locali per la cura e la conservazione dei formaggi*

kukuban = *fantasma*

llikuzhit = *lecornie, prelibatezze*

majapkat = “*fiori di Maggio*”, *fiori del sambuco*

marrunarin = *guastare, ingannare, prendere in giro*  
Massavetrat = “*Massa vetere*”, *toponomastico*  
mbëlhasur = mbilhasur = *ammuffito, guasto*  
merëngia = *tristezza, solitudine*  
mollë kurçe = *mela selvatica*  
nakatosjet = *nuasee*  
nok = *nastro, fiocco*  
rrunganxje = *arroganza*  
shaturi = *zappatore*  
shkatinj= *dispettoso*  
shqitje = *distacco, separazione*  
spavej = *spariva*  
spavtin = *scomparsi*  
tavuletrat = *solai, sottotetti*  
titarot = *piffero*  
vocele = *ragazza, giovanetta*

## BIOBIBLIOGRAFI

Nando Elmo (Nandin'i Helmravet), lindi Firmozë (Acquaformosa di Cosenza, Italy) në 03/11/38.

Bëri studhimet e mesme e të lartë te kolegji Benedetto XV e këllogjervet e Shën Nilo-t e Grottaferrata-s (Roma).

Frekuentoj Universitetin "La Sapienza" e Romës tek u kle nxënës i Koliqit.

U diplomar pra te Universiteti i Palermit, te ku freqentoj leksjonat e Gurakuqit, Valentini-t e papas Mateut Sciambra. Te kjo Universitetë njohi Zefin Skiro di Maxho, me të cilin thellojë miqësinë në Pjemont tek u të dy klen mësuese te skolla e mesme. Miqësia e tyre dha shumë peme letrare e artistike.

Torin Nando Elmo u master-izua në "Gjuhësi e përgjithëshme e Semjologjië". Këtu i muar pjesë revistes sperimentale "Offerta speciale" me vepra të vlersuara jashtshteti (në Kanada), ndersa shkruanej artikuj të ndryshme nartyrje për "Katundi Ynë", "Mondo Albanese", për rivistën telematike "Arbitalia". Nani shkruan te grupi Fejsbukjan "Shkruanj urtësisht për gjithmon arbërisht".

Si shkrimëtar italian ka botuar mbjedhje poesishë: "Januae – sistri di solstizio" (bashk me poetin liti Franco Ferrero), "Per/enne meno uno"; esëje: "Lo Specchio l'Enigma", "Un gallo ad Asclepio", "L'Angelo l'Attonito la Terra".

Ka vepra pa të botuara se si romanin (si një esë mbë mergimin): "Due arbëreshë a Torino ". Ngamon italisht, vlon te tiraturit (sirtari) dy mbledhje poesishë: "Notturmi Acquaformositani", "Canzonette dell'addio".

Ka vepruar edhe si piktor. Veprat e tija jan të shprishura n'Itali, sidomos në Pjemont e Siçilí. Pindaksi ritretat e Zotrivet të tyre: të Imzotit Stamati, të Imzotit Pal Skiro, të Arkimandritit Dhimitër Kamarda.

Illustroj me vizatime veprën e Skiro di Maxho: *Lufta e mivet me*



*brethqit.*

Një vizatim i tij dual te kopertina e librit “*Llarg dhe afër*” i Nasho Jorgaqit (1987, Tirana).

Si shkrimëtar arbëresh ndafet midhis njëj najviteti djalektal e njëj dijturie pak e sigurte. Ndifet si ai poet grek, Solomos, te filmi i Angelopoulos “*Μια αιωνιοτητα και μια Μερα*”/“*Një Përjetësië e një Ditë*”. Si ai vete ture marr hua fjalë, këtu e këtëje – pra ja truan gjykimit të Zefit Skiro di Maxho, ndaj të cilit, kjo mbjedje i ka një dëtyr të madh.

Po, yni, nëng vete ture marr hua vet fjalë, po edhe stileme, noeri, për këtë ngë do konsideruar një artist, pse së hiri kurrë ket ajo “lënsië hyjnore” e cila e vetme bën artën. Ësht, yni, vet një intelektual, i cili jo ngamon di atë çë bën.

Rivarolo Canavese 31/12/2014



Shtypur në janar 2015  
Nga Shoqata Kulturore “Mondo Albanese”  
Hora e Arbëreshëvet (Palermo)